



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS**

Nr. 812 Prot.

Patos, më 13 / 03 / 2025

PROJEKTVENDIM

Nr. 11 Datë 13 / 03 / 2025

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË TRANSPARENCËS NË PROCESIN E
VENDIMARRJES SË KËSHILLIT BASHKIAK PATOS PËR VITIN 2024**

Mbështetur në piken 3 të nenit 15 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 4 neni 120, Vlerësimi i Performancës dhe Llogaridhënia e Këshillit dhe Sekretariatit” i rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Patos”, ligji nr. 146/2014 “Për të drejtën e Konsultimit Publik”, neni 11 i VKB-së nr. 1, datë 27.01.2022 i “Rregullores për Konsultimet Publike të Këshillit Bashkiak”, po ju prezantojmë Raportin e Transparencës së Vendimarrjes së Këshillit Bashkiak për vitin 2024.

Ky Raport përmban informacion për:

Numrin e akteve të miratuara nga ograni publik përkatës gjatë vitit 2024.

Numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palet e interesuara gjatë seancave të dëgjësave publike:

Numrin e rekomandimeve të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimarrjes.

Numrin e takimeve publike të organizuara.

Referuar sa më sipër Këshilli i Bashkisë gjatë vitit 2024 ka marrë 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) vendime në total.

Nga këto vendime në total për 13 vendime janë realizuar konsultime publike.

Në lidhje me tematikat e tyre:

Vendime për çështje financiare /tati/buxheti/ nivel pagash 23

Vendime për çështje projektsh infrastrukturore 1

Vendime për çështje urbane dhe pronash 2

Vendime për çështje sociale, ndihmë ekonomike 37

Vendime për çështje arsimit , bursa 4

Vendime për çështje të ndryshme 29

Për secilin projektvendim që ka kërkuar konsultim publik është përgatitur Njoftimi dhe Kalendari i konsultimeve i cili është publikuar në rrjetet sociale të Këshillit dhe në faqen zyrtare të Bashkisë. Njoftimi dhe kalendari kanë pasur në përmbajtje elementët e përcaktuar nga ligji si data, ora, grupet e interesit dhe përshkrimi i projektaktit.

Në konsultimet publike kanë marrë pjesë anëtarët e këshillit sipas tematikave të konsultimeve publike. Procesverbalet janë mbajtur nga koordinatori i konsultimeve publike. Konsultimet publike janë realizuar në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë.

Pas mbajtjes së konsultimit publik procesverbali është protokolluar, një kopje gjendet në arkiven e bashkisë dhe një kopje është postuar në faqen zyrtare të këshillit të bashkisë. Sekretari i Këshillit i ka përcjell rekomandimet e marra drejtorive përkatëse. Po ashtu në dëgjuesat publike përveç takimeve në terren është përdorur varianti online, ku në dispozicion të qytetarëve është vendosur emaili i sekretarisë së këshillit ku ata mund të dërgonin komentet e tyre. Nga kontrolli emailit nuk rezulton ndonjë reagim apo propozim nga ana e qytetarëve.

Numrin e takimeve publike të organizuara.

Numri i takimeve publike të organizuara është 25.

Numri i përgjithshëm i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara:

Gjatë procesit konsultativ u regjistruan gjithsej 23 rekomandime konkrete.

Numri i rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara:

Nga 23 rekomandime u mbajtën parashysh 23 me motivim të arsyetuar nga ekzekutivi i cili u angazhuan në organizimin dhe drejtimin e dëgjësive publike.

Regjistri i Konsultimeve Publike gjendet i publikuar online në faqen e Këshillit të Bashkisë. Për secilin konsultim publik pas përfundimit të tij publikohet një përmbledhje e aktivitetit së bashku me fotot përkatëse.

Një nga format e publikimit ka qenë dhe informacioni i ngarkuar në rrjetin social Fb Bashkia Patos, e cila është një faqe që përditësohet çdo ditë, si një tregues tjetër i transparencës.

Njoftimet zyrtare janë afishuar në stendën e afishimeve publike dhe në vendet e dukshme në ambjente publike.

Albiona Lamaj
Zv/ Kryetare

Enkelejda Ajazi
Kryetar Grupi

Eduart Faslliaj
Zv/ Kryetar

Artan Velçani
Kryetar Grupi

KRYETARI

Armand Ahmetaj

